

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 7 TETOR 2021

Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Jemi mbledhur sot për të diskutuar për miratimin e aktit normativ për furnizimin e Shqipërisë me më shumë vaksina jetëshpëtuese ndaj COVID-it. Vaksinimi masiv është e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund kësaj pandemie. Do ta nis fjalën time duke shprehur ngushëllimet e mia të sinqerta për të gjithë familjarëve, të dashurit e të cilëve nuk ia dolën dot në luftën me COVID-19. Jam e sigurt që ka midis tyre me mijëra që bëjnë sot pyetjen: po të kishte qenë i vaksinuar, a do t'ia kishte dalë? Askush nuk e thotë dot saktësisht përgjigjen e saj, por probabiliteti është i madh që të jetë po. Po, shumë prej tyre mund të ishin sot mes familjarëve, miqve, të dashurve. Në fakt, vala e parë e COVID-19, si në të gjithë botën, ishte e befasishme.

Vala e parë e COVID-19 pati dëme të mëdha njerëzore dhe ekonomike, nxori në pah probleme e mungesa të mëdha të sistemit shëndetësor shtetëror, aq të rënda sa shumë qytetarë filluan të preferojnë të vdesin në banesa, pa asnjë shërbim shëndetësor, pasi mjeku i familjes u bë shumë vonë pjesë e skemës menaxhuese. Shqiptarët, pas rrënimit nga karantina totale e parakohshme, u rrënuan edhe më tepër ekonomikisht, duke përballuar nga xhepat e tyre thujse gjithçka, shërbimin në banesa, medikamentet, pajisjet e oksigjenit etj. Zero rimbursim e më tej rimbursime qesharake për disa medikamente, kostoja e të cilave ishte disa herë më e ulët sesa ajo e ekzaminimeve të domosdoshme për t'i përfituar ato. Vaksinimet e para filluan në janar të vitit 2021, në fakt, disa javë me vonë pas aprovimit të vaksinave të para për përdorim, si Pfizer, AstraZeneca dhe të tjera. Por duhet pranuar nga të gjithë se këto ishin vaksinime që nisën me bujën e madhe të propagandës dhe vazhduan me ritmin e breshkës pikërisht atëherë kur nevojat ishin maksimale për to; vaksinime që në krye të herës ngjallën skepticizëm te shqiptarët, të ardhura fillimisht nga shtete donatore sekrete, me pikëpyetje të mëdha për kushtet e transportit të tyre; vaksinime, të cilat u shtuan më pas, pa asnjë lloj kriteri të kontrollit e certifikimit ndërkombëtar, pa asnjë lloj kriteri për të zgjedhur më të mirën për shëndetin e qytetarëve shqiptarë, duke i bërë këta të fundit edhe me konfuzë. Kriteri i vetëm i marrjes së vaksinave nga çdo burim i mundshëm ishte ai i përdorimit të tyre si një nga armët e fushatës elektorale. Sot flitet për mbi 2 milionë doza vaksinash të mbërritura në vendin tonë, ndërkohë që me pak se çereku i tyre janë Pfizer, si një nga vaksinat me efikasitet sot në botë. Të tjerat që vazhdojnë të aplikohen janë AstraZeneca, SinoVac, CoronaVac, Sputnik V, pra janë 4 lloje të ndryshme vaksinash sot në vendin tonë, ndërkohë që disa prej tyre ende të pacertifikuara nga EMA dhe FDA-ja. Nëse ky mund të ishte një shfrytëzim i mundësive të pakta të momentit në muajin e parë, çfarë emri mund t'i vihet sot? Ka vetëm një emër: papërgjegjshmëri dhe mosvlerësim i jetës së qytetareve shqiptarë, duke mos u ofruar atyre me të mirën për shëndetin. Po sot a mund të justifikohemi dot me kohën e pamjafueshme për më shumë vaksina cilësore dhe të certifikuar? Kjo gjë e ka shtuar edhe me tepër konfuzionin, mosbesimin, pikëpyetjen ndër shqiptarë në lidhje me vaksinimin në vendin tonë. Kjo është arsyeja që ne sot renditemi të parafundit në rajon për nivelin dhe përqindjen e popullatës së vaksinuar.

Opozita, Partia Demokratike, mbështet fort vaksinimin e popullatës, si i vetmi mjet në dorën tonë për të dalë nga kjo pandemi globale me sa më pak dëme njerëzore dhe ekonomike. Ajo dhe përfaqësuesit e saj janë shprehur që në krye të herës pro vaksinimit masiv, të hershëm, cilësor e të mirinformuar të shqiptarëve, duke qenë përherë nxitës të këtij procesi. Presim që qeveria shqiptare, Ministria e Shëndetësisë të mbajë premtimin për vaksinimin e të gjithë popullatës target deri në fund të pranverës së vitit 2021 me vakcina të certifikuara, pasi çdo qindarkë e shpenzuar për jetën dhe shëndetin e qytetarëve është më se e justifikuar dhe shumë më e vlefshme, në raport me çdolloj destinacioni tjetër. Faleminderit!